



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Prishtinë, 2021

Në mbështetje të nenit 10, 11 të Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funkcionimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura, nenin 8, paragrafi 1.4 të Rregullores (QRK) Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjesisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, nenin 5 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, Ligjin Nr. 07/L-041 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2021 dhe Ligji Nr. 08/L-016 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 07/L-041 mbi ndarjet buxhetore për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2021, lidhet kjo:

MARRËVESHJE PËR MBËSHTETJE FINANCIARE TË PROJEKTIT
“REHABILITIMI I RRUGËS LIPJAN RUBOFC “ KOMUNA LIPJAN

Ndërmjet :

1. Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal e përfaqësuar nga Ministri i MAPL-së (në tekstin e mëtejme MAPL),
dhe,
2. Komuna e Lipjanit përfaqësuar nga Kryetari Komunës, (në tekstin e mëtejme Komuna).

Neni 1 Qëllimi

Marrëveshja parasheh të drejtat dhe detyrimet e palëve në respektimin e rregullave të përcaktuara për financim të projektit, afatet dhe kushtet e tjera kontraktuale për subjektet juridike, me qëllim të shfrytëzimit të drejtë të buxhetit të ofruar nga MAPL.

Neni 2 Objekti i Marrëveshjes

1. Kjo marrëveshje ka për objekt bashkëfinancimin e projektit si në vijim:

“Rehabilitimi i rrugës Lipjan Rubofc”.

Neni 3 Vlera e projektit dhe mënyra e financimit

1. Shuma totale e projektit në vlerën paralogaritare është 170,000.00 €.
2. Shuma totale e ndarë nga buxheti i MAPL -ës për vitin 2021, është 50,000.00 €.
3. Shuma totale e ndarë nga buxheti i Komunës për vitin 2021, është 120,000.00 €.
4. Çdo vlerë që e kalon vlerën paralogaritare të projektit financohet nga buxheti i komunës.

Neni 4 Të drejtat dhe detyrimet e MAPL-ës

1. MAPL-ja i zoton mjetet për projektin nga neni 3 paragrafi 2. të kësaj Marrëveshje dhe një kopje e dërgon në Komunë.
2. Pagesat nga MAPL, për vlerën e financimit do të bëhen në bazë të realizimit të punimeve/furnizimeve sipas kushteve të kontratës.
3. MAPL përmes monitoruesit është në kontakt të vazhdueshëm me komunën për këtë projekt dhe në rast se vëren parregullsi apo defekte gjatë realizimit të kontratës/projektit njofton menaxhmentin e MAPL-ës.

Neni 5 Të drejtat dhe detyrimet e Komunës

1. Komuna ka të drejtën e financimit të projektit sipas nenit 2 të kësaj marrëveshjeje .
2. Komuna obligohet të zhvillojë procedurat për implementimin e projektit bazuar në legjislacionin në fuqi dhe në përputhje me këtë marrëveshjeje.
3. Komuna obligohet që pas nënshkrimit të kontratës me Operatorin Ekonomik (OE), të sjellë në MAPL një kopje të kontratës dhe ofertën financiare identike me origjinalin, së bashku me informatat për biznesin me qëllim të nxjerrjes së urdhër blerjes, si vijon:
 - certifikatën për regjistrimin e biznesit - ARBK;
 - vërtetimi i llogarisë bankare :

- kopja e dokumentit identifikues të pronarit të biznesit.

4. Komuna cakton projekt menaxherin/organin mbikëqyrës për mbikëqyrjen e kryerjes së punimeve dhe komisionin i cili lëshon certifikatën e pranimit të punimeve/pranimin teknik.
5. Komuna obligohet që të njoftojë MAPL-ën për çdo propozim ndryshim eventual të sasisë dhe kualitetit gjatë implementimit të projektit. Për projektet e financuara nga buxheti i MAPL-ës, Komuna duhet të merr aprovim paraprak në rast të nevojës për zhvillimin e punimeve shtesë.
6. Komuna obligohet të informojë MAPL-ën për dinamikën e punimeve deri në përfundim të projektit.
7. Komuna obligohet që 7 (shtatë) ditë para inaugurimit të projektit të njoftoj MAPL dhe të dërgoj ftesën për pjesëmarrje.
8. Komuna obligohet të vendosë tabelën informuese në vend ndërtim me të gjitha informatat e nevojshme.

Neni 6

Dokumentacioni i nevojshëm për pagesë nga Komuna

1. Komuna obligohet që për realizimin e pagesave për punët/furnizimet e kryera të kompletoj dokumentacionin si në vijim:
 - 1.1. Kopjen e Kontratës të nënshkruar së bashku me kushtet e përgjithshme, të veçanta dhe ofertën financiare e cila duhet të jetë identike me origjinalin e vërtetuar nga menaxheri i prokurimit të komunës.
 - 1.2. Vendimin për caktimin e projekt menaxherit/organit mbikëqyrës/komisionin e pranimit nga ana e Komunës, në rast se nuk është e definuar me kushtet e veçanta në kontratë.
 - 1.3. Raportin e projekt menaxherit/organit mbikëqyrës, komisionit të pranimit mbi punët/furnizimet e kryera të aprovuara (origjinali).
 - 1.4. Faturën nga operatori ekonomik dhe situacionin e aprovuar (origjinali).
 - 1.5. Sigurimin e ekzekutimit, garanacionin e kualitetit me pranim teknik sipas kushteve të kontratës.

Neni 7
Afati i realizimit të projektit

1. Komuna duhet të ndërmerr të gjitha masat që projekti të përfundojë brenda vitit buxhetor 2021.
2. Pas përfundimit të afatit të përcaktuar në paragrafin 1 të këtij neni, të gjitha detyrimet i bartë Komuna.

Neni 8
Pronësia e projektit

1. Pas pranimit teknik të projektit nga Komuna , projekti i financuar sipas kësaj marrëveshje do të transferohet në pronësi të Komunës.
2. Komuna është e detyruar të regjistrojë projektet nën pronësi të saj brenda sistemit të aseteve të Ministrisë së Financave (SIMFK).
3. Projekti kalon në pronësi të komunës në rastin kur pasuria jo financiare i ka kaluar të gjitha rregullat dhe procedurat e dorëzimit, pagesën e fundit me pranim teknik, kur MAPL i kryen të gjitha pagesat e situacioneve. Me këtë rast, MAPL mbyll llogarinë e investimeve, ndërsa Komuna, pasurinë jo financiare të pranuar nga MAPL e regjistron në regjistrat e pasurisë jo financiare të saj.

Neni 9
Ndryshimet dhe ndërprerja e Marrëveshjes së financimit

1. Marrëveshja mund të ndryshohet dhe plotësohet sipas pëlqimit paraprak të MAPL-ës dhe Komunës.
2. MAPL mbajnë të drejtën e ndërprerjes së Marrëveshjes në rast se Komuna nuk i përmbahet kushteve të kësaj marrëveshje.


Neni 10
Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Palët janë pajtuar që mosmarrëveshjet e mundshme të zgjidhen me mirëkuptim.

Neni 11
Hyrja në fuqi

1. Kjo marrëveshje hyn në fuqi në momentin e nënshkrimit të saj nga MAPL dhe Komuna.
2. Kjo marrëveshje është nënshkruar në gjuhën shqipe dhe serbe dhe nga dy (2) kopje autentike, një për secilën nga palët nënshkruese.

Elbert Krasniqi,
Ministër i MAPL-së



Imri Ahmeti,
Kryetar i Komunës së Lipjanit

